



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 26.06.2023

Nr: 674

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE NR. 374 ID, 375 ID, 385 ID, 390 ID, 436 ID dhe 439 ID
PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

-Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.

Data: 26.06.2023

Nr: 674
Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 374, 375, 385, 390, 436 dhe 439 ID.”

-Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 3.5.2023, është administruar shkresa me nr. 4562., nga z. Ivi Kaso, i regjistruar me nr. 374 ID, me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Vërehet në mënyrë të përsëritur përdorimi i ambjentëve të institucioneve arsimore për aktivitete të fushatës elektorale. Informacionet vijnw edhe nga Librazhdi ku Kandidati i PS për këtë bashki ka urdhëruar hapjen e shkollës dhe përdorimin e ambjentëve për takime elektorale.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 3.5.2023, është administruar shkresa me nr. 4562., nga z. Ivi Kaso, i regjistruar me nr. 375 ID, me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Gledi Llatja njofton në rrjetin social FB: Bonuset për rijetësimin për pronarë e përdorues të objekteve të ndryshme; Së bashku me znj.Elva Margariti, z.Damian Gjikhuri, deputetë të zonës promovojnë nismën e qeverisë për Bonusin e Rijetësimit; Prezent së bashku me ministren znj.Elvis Kushi dhe z.Damian Gjikhuri gjatë zhvillimit të një aktiviteti në pallatin e sportit "Tomorr Sinani" Elbasan; Promovon projekte infrastrukurore në shkollën "Luigj Gurakuqi" Elbasan, shkollën "Konstandin Kristoforidhi" Elbasan, shkollën artistike "Onufri" Elbasan; Së bashku me ministren znj.Bora Muzhaqi dhe nxënës prezantojnë kurset e kodimit me mbështetje nga qeveria, prezent në qendrën Rajonale të Formimit Profesional dhe Qendrën Rinore Elbasan; Së bashku me Kryeministrin dhe me prezencën e z.Gjikhurit, Llatja promovon Auto Moto Park Albania; G.Llatja promovon rritjen e pagave të punonjësve; Z.Gjikhuri dhe z.Llatja promovojnë investime të reja në fabriken "M&M Topuzi Konstruksiione Metalike" në Elbasan;*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 3.5.2023, është administruar shkresa me nr. 4544., nga z. Ivi Kaso, i regjistruar me nr. 385 ID, me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Kryetari i Bashkisë Tiranë, z.Erion Veliaj me miratimin e Kryeministrit, pak ditë përpara zgjedhjeve miraton 7(shtatë) leje të reja ndertimi për kulla në Tiranë.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 2.5.2023, nëpërmjet postës elektorinike Partia Demokratike, Dega Maliq, ka përcjellë denoncimin të regjistruar me nr. 390 ID me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Më datë 2 maj 2023, ora 14:30, Kryeministri z.Edi Rama zhvilloj një takim elektorale në Bashkinë Maliq, Njësia Administrative Maliq. Në takim ishin të pranishëm edhe Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi. Në takim ishin të pranishëm në një masë të madhe punonjësit e bashkisë Maliq, Brenda orarit zyrtar.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 3.5.2023 është administruar denoncimi nëpërmjet portalit me nr. 13165 ID i regjistruar me nr. 436 ID, me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Në bazë të ligjit të republikës së Shqipërisë dhe Kodit Zgjedhor nuk lejohen shtrimet e rrugëve elektorale, ku në 1 muaj të fushatës zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj punimesh apo formash në kundërshtim me ligjin për të përfutur votën. Kryetarja e Bashkisë*

Dimal, z.Juliana Memaj ka shkelur ligjin duke shtruar rrugë elektorale me çakull për të përfituar vota. Duam që nga organet ligj zbatuese të meren masa.”

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 30.4.2023 është administruar denoncimi nëpërmjet portalit me nr. 12934 ID i regjistruar me nr. 439 ID, me lëndë “Përdorimi i burimeve publike”, me objekt denoncimi “Në zbatim të Lgjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor, Neni 39, Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së, pika 2 2. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra me vendim të KZAZ-së kur: janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë; Dhe përjashtim siç e kërkon ligji për persona që ndodhen në listën e dorëzuar nga dega e PD-së Tropojë të komisionerëve të QV-së pranë KZAZ-së nr.9 Tropojë.”

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimeve nr. 374, 375, 385, 390, 436 dhe 439 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI